Vendim nr. 302, datë 28.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Asim Vokshi,	Anëtar
Marjana Semini,	Anëtare

në datën 28.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 24 (E) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ERION ÇEREKJA,** përfaqësuar nga avokati Agron Lamaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 11-2020-4266, datë 30.09.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2021-359, datë 02.03.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2025-1502, datë 16.09.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 42, pika 2, 43, 44, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 50, pika 4, 71, pika 1, dhe 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka paraqitur kallëzim penal kundër shtetasit Gj.T. në ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me detyrë "prokuror" në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kryerjen e veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal *(KP)*. Ky material kallëzues i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*Prokuroria Durrës*).

2. Kërkuesi ka pretenduar në kallëzim se në një çështje gjyqësore civile ku është palë ndërgjyqëse, ekspertja e caktuar nga gjykata, shtetasja E.G., ka hartuar një aktekspertim të rremë, shkak për të cilin ka paraqitur kallëzim penal ndaj ekspertes, për veprën penale "Ekspertimi i rremë", të parashikuar nga neni 309 i KP-së. Materiali kallëzues është trajtuar nga prokurori Gj.T., i cili pas shqyrtimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, me argumentin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale dhe se faktet janë hetuar më parë.

3. Sipas kërkuesit, nga ana e prokurorit janë kryer shkelje të rënda, të cilat konsistojnë në mosdhënien e informacionit për regjistrimin e çështjes dhe ecurinë e hetimit, thirrjen për t'u pyetur, mbylljen e çështjes pa kryer hetime, veprime të njëanshme dhe duke shpërdoruar detyrën e tij, fshehjen e të dhënave dhe provave, me qëllim për të ndihmuar eksperten dhe palët e tjera që kanë kryer një sërë veprash penale, mosdhënien e kopjes së dosjes dhe mosparaqitjes në disa seanca gjyqësore, favorizimin e ekspertes dhe indirekt ka ndihmuar nëpërmjet shkeljeve ligjore disa shoqëri ndërtuese që kanë kryer vepra penale dhe që janë në hetim pranë prokurorisë.

4. Me vendimin e datës 19.12.2019, Prokuroria e Durrësit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal bazuar në nenin 290, pika 1, shkronja "ç", të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), duke argumentuar se fakti i kallëzuar nuk përbën vepër penale. Sipas saj, organi i akuzës nuk mund të hetojë ligjshmërinë e vendimmarrjes ose të urdhëresave të një gjykate ose të një prokurori, apo të kontrollojë zbatimin prej saj të procedurave ligjore, të ligjit material dhe procedural, përderisa sistemi ynë i së drejtës, kuadri normativ kushtetues dhe ligjor në fuqi, si dhe parimet e procesit të rregullt ligjor vendosin shkallët hierarkike të gjyqësorit si mekanizma kontrolli ndaj gjykatave më të ulëta, duke parashikuar edhe instrumentet ligjore për ndreqjen eventuale të vendimeve gjyqësore. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim kërkuesi.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 11-2020-4266, datë 30.09.2020, ka vendosur rrëzimin e tij. Ajo gjykatë e ka vlerësuar të drejtë vendimmarrjen e organit të akuzës për mosfillimin e çështjes penale, pasi në rastin konkret nuk ekzistojnë elementet e figurës së veprës penale "Shpërdorimi i detyrës", të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Sipas gjykatës së apelit, vendimi i prokurorit Gj.T. është bërë objekt ankimi edhe në

Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 3602, datë 16.10.2019, e ka gjetur të ligjshëm vendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal. Në këto kushte, sipas asaj gjykate, vendimmarrja e prokurorit Gj.T. është konfirmuar me vendim të formës së prerë dhe në kushtet që kërkuesi ka paraqitur të njëjtat pretendime ato përbëjnë gjë të gjykuar.

6. Për ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2021-359 datë 02.03.2021, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndër të tjera, gjykata e apelit ka arsyetuar se referuar akteve të fashikullit të veprimeve verifikuese, prokurori ka vepruar në përputhje me kriteret e rastet e parashikuara në nenin 290, pika 1, shkronja "ç", të KPP-së dhe se në ankimin e paraqitur nga kërkuesi nuk gjenden shkaqe që e bëjnë të cenueshëm vendimmarrjen e organit të prokurorisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-1502, datë 16.09.2025, ka vendosur mospranimin e tij, me arsyetimin se ai nuk përmbante ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

8. Në datën 17.03.2026 (sipas shërbimit postar) kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 03.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

9. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:

9.1. *Së drejtës për t'u mbrojtur, aksesit dhe parimit të kontradiktoritetit,* pasi: i) gjykimi në gjykatën e shkallës së parë është zhvilluar në mungesë të viktimës, pa u njoftuar rregullisht për zhvillimin e seancës; ii) Gjykata e Lartë nuk ka marrë në konsideratë kërkesën me shkrim për shtyrjen e gjykimit.

9.2. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj,* pasi: i) gjyqtari V.S., i cili ka shqyrtuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë, megjithëse ishte në dijeni të kërkesës për përjashtim, pa pritur vendimmarrjen e trupit gjykues që kishte shqyrtuar këtë kërkesë, ka vazhduar gjykimin; ii) gjykata e apelit pa ia nënshtruar debatit gjyqësor ka administruar si provë vendimin nr. 11-2020-3132, datë

17.07.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit për përjashtimin e gjyqtarit V.S. Mosmarrja dijeni për ekzistencën e këtij akti i ka kufizuar edhe të drejtën e aksesit për t'iu drejtuar Gjykatës së Lartë.

9.3. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave të zakonshme nuk u kanë dhënë përgjigje pretendimeve për rastin në shqyrtim, por duke iu referuar një vendimi të mëparshëm e konsiderojnë çështjen e paraqitur për gjykim si "gjë e gjykuar".

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

10. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, individi duhet të provojë interesin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete, Kolegji evidenton se kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor penal të përmbyllur në të tria shkallët e gjyqësorit, që ka vendosur për mosfillimin e procedimit penal për veprën penale "Shpërdorimi i detyrës", ku ai ishte kallëzues, me pretendimin se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të *së drejtës për t'u mbrojtur, aksesit dhe parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj*, si dhe *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*. Për rrjedhojë, çmohet se, nga pikëpamja procedurale, kërkuesi e justifikon interesin e tij në çështjen e parashtruar, pasi ka qenë kallëzues në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara.

12. Për sa i përket aspektit substancial të legjitimimit *ratione personae*, në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se individi, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejtë, si

dhe të tregojë se në çfarë mënyre ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, kërkuesi duhet të justifikojë interesin kushtetues për çështjen e parashtruar përpara Gjykatës, pra se cenimi i të drejtave themelore prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara është vetjak, i drejtpërdrejtë dhe real.

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se në thelb kërkuesi ka kundërshtuar procesin gjyqësor në përfundim të të cilit është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe në këtë kuptim mosndjekja penale e prokurorit Gj.T. të kallëzuar prej tij për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i KP-së. Në lidhje me këtë, gjykatat kanë arritur në përfundimin se ankimi ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit, në përmbajtjen e tij, nuk ka asnjë shkak për të cilin të kërkohet të cenohet. Të tria gjykatat e juridiksionit të zakonshëm e kanë konsideruar të drejtë vendimmarrjen e prokurorit, duke vendosur se vendimi i mosfillimit të procedimit penal ishte i argumentuar, pasi në rastin konkret nuk evidentoheshin elemente të veprës penale të pretenduara nga kërkuesi. Për më tepër, vendimi i prokurorit Gj.T. për mosfillimin e procedimit penal ndaj ekspertes E.G. për veprën penale "Ekspertimi i rremë", të parashikuar nga neni 309 i KP-së ishte bërë edhe objekt shqyrtimi gjyqësor duke u gjetur si i drejtë.

14. Po kështu, edhe për pretendimin e kërkuesit për *cenimin e së drejtës së pronës* si rezultat i veprimeve të kundërligjshme të ekspertes, Kolegji vlerëson se procesi penal duket se nuk mund të sjellë pasojat materiale që kërkuesi synon, përveçse ky proces as nuk e kushtëzon kërkuesin në përdorimin e mjeteve ligjore për mbrojtjen e së drejtës së pronës që pretendon se i është shkelur.

15. Bazuar në këto konsiderata, si dhe duke pasur parasysh se Kushtetuta dhe KEDNJ-ja nuk garantojnë të drejtën për të filluar ndjekje penale kundër personave të tretë ose për dënimin e tyre *(shih çështjen Renata Mckay-Kopecka kundër Polonisë, datë 19.09.2006)*, Kolegji vlerëson se kallëzimi penal ndaj personave të tretë nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar interesin e kërkuesit në çështjen kushtetuese të parashtruar, në kuptimin që vendimet dhe procesi i kundërshtuar të sjellin pasoja reale dhe të drejtpërdrejta në të drejtat dhe liritë themelore individuale të tij. Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës.

16. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

17. Nisur nga sa më sipër, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "b", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.